

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,23,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin , me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është e obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

Të dëmtuarit – [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] Rr. "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] Rr." [REDAKTUAR] nr [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhezohet ne kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 60.88 € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/11.nr.1302-3/15, të dt. 16.06.2016 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/11.nr.1302-3/15, të dt. 16.06.2016, me arsytim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: deklrata e të dëmtuarve me datë 02.08.2015 dhe të pandehurit me datë 02.08.2015, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit [REDAKTUAR] të datës 08.06.2016 mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. [REDAKTUAR] i datës 15.02.2015, vërtetoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se e pandehura e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtorë dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit - [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] Rr. "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] Rr." [REDAKTUAR] nr [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për realizimin e kërkeses pasurore juridike udhezohet në kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njetete) € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.541/16 datë 14.10.2016

**Procesmbajtëse,
Nora Rushiti**

**Gjyqtarja Individuale,
Hakile Ilazi**



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.